

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** Mirëmbajtje e thellë e hidroizolimit të taracave në objektet arsimore dhe godinat publike.

#### **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Kodi CPV: 45261420-4 - Punime hidroizolimi

**VLERA E FONDIT LIMIT: 6 912 948** (*gjashhtë milion e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e tetë*) **Lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Sigurimin e ofertës, sipas shtojcës 3;*

b. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DT.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

#### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

##### **2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e operatorit ekonomik ofertues lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- NP - 3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale.
- NS - 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 2, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 6, gërma a) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr.8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “.....Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.....” Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të pasqyruara në preventiv. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**2.1.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht punime cilësore që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së.

**2.1.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 45001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e shëndetit dhe sigurisë në punë. Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Është kërkuar kjo certifikatë pasi ofron një kuadër për menaxhimin efikas të shëndetit dhe sigurisë në punë përfshirë gjithë aspektet e menaxhimit të riskut dhe të përputhshmërisë ligjore nga operatorë ekonomikë, të cilët do të ekzekutojnë këtë kontratë punë publike. Një operator ekonomik i certifikuar sipas këtij standardi është në gjendje të:

- Krijojë kushtet më të mira të punës në gjithë organizatën e tij;
- Identifikojë kërcënimet dhe vendos kontrollin për menaxhimin e tyre;]
- Redukton aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën
- Joproductive;
- Përfshin dhe motivon stafin me kushte më të mira dhe më të sigurta pune;
- Dëshmon përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve;

Të gjitha këto janë garanci se operatori ekonomik i shpallur fitues i cili është i certifikuar sipas këtij standardi ka kapacitetet e duhura për realizuar me sukses kontratat me AK-të.

**2.1.4** Organi i vlerësimit të konformitetit të certifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", VKM nr. 667, datë 29.7.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit". Çertifikatat e lëshuara nga ente certifikuese të pa akredituara nuk garantojnë efikasitetin dhe sigurinë për kërkesat e cilësisë të cilat autoriteti kontraktor i kërkon për realizimin e kontratës.

**2.1.5** Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B "Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e Mbetjeve Urbane", sipas parashikimeve ligjore në Ligjin Nr.9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta"(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë") Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 2, 87 pika 2 germa a) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39 pika 6 germa a) dhe pika 7 germa c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (të ndryshuar) si dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcakton Ligji Nr.9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (të ndryshuar). Ky kriter synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme. Duke qënë se në preventivin e punimeve janë pasqyruar punime prishje është gjykuar se subjekti duhet të ketë lejen e posaçme për veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme ndërtimore. Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit ku parashikohen transportim materiale inertesh dhe dhera për shkak të gërmimeve dhe prishjeve. (Seksioni I-rë i preventivit “Punime të ndryshme dhe prishje”).

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

**2.2.2** Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Udhëzimin nr.7, datë 10.01.2017 “Për disa shtesa në Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar). Në përcaktimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” (të ndryshuar), ku citohet .....“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji”.... Përcaktimi i vlerës së kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2023 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Duke qenë se autoriteti kontraktor është njësi e autoriteteve vendore e gjen të arsyeshme që pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë ofertues në këtë procedurë prokurimi ta kushtëzojë me shlyerjen në kohë të taksave vendore të parashikuara me ligj.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin:

- a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.

**Shënim:** *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Faturat tatimore për këtë situacion;
- Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit

limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses në kohën e përcaktuar dhe sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh Ekonomikë (BOE), nga operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni Autoriteti Kontraktor ka mundësi të njihet me llojin, sasinë dhe vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE. Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përlllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i operatorit ekonomik ofertues), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekte, i cili duhet të figurojë në listëpagesën e subjektit për periudhën Maj 2023 – Qershor 2023 dhe në vazhdim, dhe të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj 2023 – Qershor 2023.

***Shënim:** Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimin dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesën e subjektit për periudhën Tetor 2022 – Nëntor 2022 dhe në vazhdim, specialistët si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier ndërtimi, i cili duhet të jetë drejtues teknik i shoqërisë.
- 1 (një) Inxhinier mekanik

Për specialistët e mësipërm duhet të paraqiten:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj 2023 – Qershor 2023.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar të jo më pak se 38 (tridhjetë e tetë) punonjësve për periudhën Maj 2023 – Qershor 2023 dhe në vazhdim, të vërtetuar me dokumentacionin si vijon;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Maj 2023 – Qershor 2023.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj 2023 – Qershor 2023.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/liçensuara sipas Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Maj 2023 – Qershor 2023 dhe në vazhdim, minimumi:

- 1 (një) punonjës teknik ndërtimi
- 1 (një) punonjës hidroizolues

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/çertifikatë e arsimit profesional);
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj 2023 – Qershor 2023.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) punonjës i cili të jetë i pajisur me çertifikatën e trajnimit si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” ose ekuivalente dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Maj 2023 – Qershor 2023 dhe në vazhdim, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores për sigurinë në kantier”. Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente çertifikuese të akredituara/liçensuara.



**Shënim:** Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi për pikat 2.3.2, 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6.** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6 germat c) dhe ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të prokurohen siç janë punimet për mirëmbajtjen e objekteve arsimore është e nevojshme pasja e një stafi teknik të kualifikuar e vërtetuar kjo në bazë të kodeve të punësimit të profesioneve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, për realizimin me sukses të kontratës. Punonjësit e kualifikuar janë kërkuar duke u bazuar në numrin e objekteve në të cilat do të kryhen punimet si dhe natyrën dhe sasinë e punimeve që kërkohen. Me qëllim garantimin e realizimit të kontratës, stafi teknik inxhinierik dhe punonjësit e kërkuar nga autoriteti kontraktor duhet të figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

**2.3.2** Kriteri për të patur në stafin e operatorit ekonomik ofertues drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Detyrimi i administratorit të operatorit ekonomik ofertues për të përcaktuar me shkresë Drejtuesin Teknik të punimeve objekt të kontratës është bazuar në Ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pasi për çdo objekt zbatimimi duhet të ketë drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë ligj dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

**2.3.3 a)** Kërkesa për **inxhinierin e ndërtimit** është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij specialisti të lartë pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit të prokurimit. Është kërkuar inxhinier ndërtimi për zbatimin e punimeve në përputhje me zërat e pasqyruara në preventivit, termave të referencës dhe specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit. Inxhinieri i ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të preventivit për secilin nga zërat e punimeve dhe për cilësinë e materialeve që vendosen në objektet ku do të kryhen punimet.

**b)** Kërkesa për **inxhinierin mekanik** është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Natyra e punimeve të ndërtimit për realizimin e objektit të kontratës e bën të nevojshme asistencën dhe praninë në objekt gjatë punimeve të këtij specialisti të lartë. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit të prokurimit. Është kërkuar inxhinier mekanik për zbatimin e punimeve në përputhje me

zërat e pasqyruara në preventiv, termave të referencës dhe specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit. Inxhinieri mekanik është përgjegjës për zbatimin e zërave të preventivit për të cilat nevojiten përlogaritje të sakta të përdorimit të mjeteve teknike të hidroizolimit me gaz të lëngshëm dhe materialeve prej metali një pjesë e të cilave duhet patjetër të përshtaten për kryerjen e funksioneve të parashikuara me efektivitet maksimal në objekt. Gjithashtu inxhinieri mekanik do të ndjekë nga afër secilin nga zërat e punimeve dhe kontrollojë cilësinë e materialeve që vendosen në objektet ku do të kryhen punimet.

**2.3.4** Për sa i përket përcaktimit të numrit të përgjithshëm të punonjësve të nevojshëm për realizimin e kontratës jemi bazuar tek zberthimi i zërave preventivit, kohëzgjatja e kontratës dhe përcaktimi i orëve të punës të përlogaritura në bazë të parashikimeve ligjore në nenin 19 pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” dhe çmimet e Manualit të Punimeve të Ndërtimit i miratuar nga Këshilli Ministrave me Vendimin nr.629 datë 15.07.2015 (i ndryshuar), dhe analizave teknike për punimet e ndërtimit.

**Këtë përlogaritje si nevojë e transparencës ndaj ofertuesve e kemi paraqitur të detajuar si më poshtë:**

Shkolla 9-Vjeçare " Kongresi i Lushnjes "						
PËRLOGARITJA E ORËVE TË PUNËS						
Nr.	Nr. Manuali + Analizë	Përshkrimi i Punimeve	Njësia	Sasia	Orë pune për njësi	Orë pune gjithsej
	<b>I</b>	<b>PUNIME PRISHJE</b>				
1	Analizë	Prishje e shtresës së dyshemesë deri në sip. e betonit	m <sup>3</sup>	128	5.39	689.9
2	2.37/5b + Analizë	Transport materiale ndërtimi, me auto deri në 10 km	m <sup>3</sup>	142	-	-
	<b>II</b>	<b>PUNIME HIDROIZOLIMI</b>				-
1	2.423/a + Analizë	Shtresë avullizoluese gjeotekstil	m <sup>2</sup>	912	0.40	364.8
2	2.264 + Analizë	Shtresë llustër çimento 1:2	m <sup>2</sup>	914	0.66	603.2
3	2.239/a + Analizë	Shtresë termoizoluese me polisterol t=10 cm	m <sup>2</sup>	912	0.75	684.0
4	2.197 + Analizë	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2k katrama	m <sup>2</sup>	914	1.00	914.0
5	Analizë	Shtresë betoni lehtësuar për pjerrësi tmes = 6cm	m <sup>2</sup>	914	1.35	1,233.9
6	2.264 + Analizë	Shtresë llustër çimento 1:2 (t=40mm)	m <sup>2</sup>	914	1.50	1,371.0
7	2.203 + Analizë	Veshje kornizë llamarine xingato	m <sup>2</sup>	162	1.60	259.2
8	2.206 + Analizë	Kasetë shkarkimi me llamarinë xingato	copë	10	2.42	24.2
9	2.209 + Analizë	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat Ø 100	ml	78	1.09	85.0
		<b>SHUMA I</b>				<b>6,229.3</b>

PËRSHKRIMI	PËRLLOGARITJA	REZULTATI
Orë pune në total për kryerjen e punimeve (referuar normativës sipas Manualit Teknik dhe Analizës Teknike) →	Shumatorja e orëve të punës sipas preventivit =	<b>6,229.3</b>
Ditë pune 8 orarëshe në total për kryerjen e punimeve →	Orë pune Total (6229.3 orë)/8 orë në ditë =	<b>778.7</b>
Periodha në ditë e parashikuar për kryerjen e punimeve për 30 ditë kalendarike	30 ditë kalendarike = (22) ditë faktike pune në muaj =	<b>22</b>
Numri i fuqisë punëtore për kryerjen e punimeve për 22 ditë pune faktike →	778.7 ditë pune total /22 ditë =	<b>35.4</b>
Numri i specialistëve të lartë (inxhinierë) →	Specialistë të lartë =	<b>2</b>
Numri i fuqisë punëtore <b>GJITHSEJ</b> →	Specialistë të lartë + punonjës =	<b>37.4</b>

**2.3.5** Për sa i përket përcaktimit të punonjësve të kualifikuar nga institucione të arsimit profesional kjo kërkesë del e nevojshme nga shqyrtimi i prevetivit të pasqyruar ku sasia dhe lloji i shërbimeve e bëjnë të domosdoshëm vendosjen e këtij kriteri në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

- 1) 1 (një) punonjës teknik ndërtimi i kualifikuar është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekt. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në të njëjtin objekt me një kohë të përcaktuar sipas grafikut të punimeve, është gjykuar që të paktën 1 (një) punonjës teknik ndërtimi i kualifikuar është të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.
- 2) 1 (një) punonjës punonjës hidroizolues të kualifikuar janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekt. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe pjesën kryesore të punimeve e mbajnë punimet hidroizoluese, është gjykuar që të paktën 1 (një) punonjës hidroizolues të kualifikuar është i nevojshëm për realizimin e kontratës.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatën e trajnimit si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” ose ekuivalente dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Maj 2023 – Qershor 2023 dhe në vazhdim, në përputhje me klauzolat e Ligjit nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores për sigurinë në kantier”. Për punonjësën e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente certifikuese të akredituara/liçensuara.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 77 pika 4, nenin 76 pika 3 germa a) të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6 germa c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i cili përcakton se..... Neni 7....Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit....1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion...., dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores për sigurinë në kantier”. Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion për posedimin e mjeteve/pajisjeve teknike dhe mbrojtëse në pronësi ose me qira, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, minimumi për mjetet/pajisjet teknike dhe mbrojtëse si më poshtë;

Nr.	Kreu I - Mjetet dhe pajisjet teknike	Sasia minimale	Gjendja
1	Kamion me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qira
2	Gjenerator $\geq$ 5kw	1 copë	Pronësi ose me qira
3	Depozitë uji 1000-3000lt	1 copë	Pronësi ose me qira
4	Vinç karrel	1 copë	Pronësi ose me qira
5	Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qira
Nr.	Kreu II - Mjetet dhe pajisjet mbrojtëse	Sasia minimale	Gjendja
1	Helmetë mbrojtëse për kokën	38 copë	Pronësi ose me qira
2	Jelekë me shirita fosforishentë	38 copë	Pronësi ose me qira
3	Fikëse zjarri të lëvizshme $\geq$ 5kg	2 copë	Pronësi ose me qira
4	Tabela Sigurimi Teknik	8 copë	Pronësi ose me qira
5	Kuti e Ndihmës së shpejtë	2 copë	Pronësi ose me qira

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), kurse për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*).
- b) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënesit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.
- c) Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas Shtojcës 8.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.7) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 germa d), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë shërbimet për lyerjen dhe mirëmbajtjen periodike të objekteve arsimore, të cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, makineritë dhe pajisjet mbrojtëse të përcaktuara më sipër. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme zotërimi i këtyre pajisjeve specifike, të konsideruar nga Autoriteti kontraktor si të domosdoshme për realizimin e shërbimit në përputhje me ligjislacionin e punës. Referuar natyrës së objektit të prokurimit për realizimin me sukses të shërbimeve është e nevojshme pajisja e këtyre mjeteve teknike.

## **KREU I**

**1) Kamion me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton** për transportimin e materialeve ndërtimore dhe mbeturinave në objekt është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv, natyra e shpërndarjes së punimeve në objekte. Duke patur parasysh se një pjesë e punimeve të objekteve kërkojnë zhvendosje materialeve ndërtimore me volum të lartë, është gjykuar që të paktën 2 (dy) mjete të tillë janë të nevojshëm për zbatimin e kontratës.

**2) Gjenerator  $\geq 5kw$** , është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e materialeve dhe llojin e punimeve të parashikuar në preventiv ku është e nevojshme lidhja e mjeteve teknike montuese me energji elektrike, është gjykuar që të paktën 1(një) pajisje teknike e tillë është e nevojshme për zbatimin e kontratës pasi në raste të paparashikuara mund të ndodhë ndërprerje e energjisë elektrike dhe kjo do të sillte pasoja në përmbushjen me sukses të kontratës në afatin e parashikuar.

**3) Depozitë uji 1000-3000lt**, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekt. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e materialeve dhe llojin e punimeve të parashikuar në preventiv ku është e nevojshme përgatitja e materialeve ndërtimore në objekt, është gjykuar që të paktën 1 (një) pajisje teknike e tillë është e nevojshme për zbatimin e kontratës pasi në raste të paparashikuara mund të ndodhë pamundësi e furnizimit me ujë dhe kjo do të sillte pasoja në përmbushjen me sukses të kontratës në afatin e parashikuar.

**4) Vinç karrel**, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e materialeve që do të hiqen nga objektet dhe vendosjen e materialeve ndërtimore të parashikuara për montim ku një pjesë e tyre është e nevojshme që transporti në vendin e montimit për shkak të përmasave të tyre të bëhet nga ana e fasadës së objektit, është gjykuar që të paktën 1 (një) pajisje teknike e tillë është e nevojshme për zbatimin e kontratës.

**5) Matrapik**, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekt. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e materialeve që do të hiqen nga objekti duke nxjerrë tabanin fillestar të betonit, është gjykuar që të paktën 2 (dy) pajisje teknike të tilla janë të nevojshme për zbatimin e kontratës.

**KREU II) Helmetë mbrojtëse për kokën, Jelekë me shirita fosforishentë, Fikëse zjarri të lëvizshme  $\geq 5kg$ , Tabela Sigurimi Teknik, Kutit e Ndihmës së shpejtë**, janë kërkuar për të realizuar me efikasitet mbrojtjen dhe sigurinë në punë për punonjësit e nevojshëm për realizimin e kontratës. Këto mjete mbrojtëse të pasqyruara në Kreun II të Tabelës në pikën 2.3.8, janë kërkuar në përputhje me natyrën e punimeve, njëkohësisht dhe numrin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e kontratës dhe kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Është përllogaritur që sasia e kërkuar të jetë në propocion të barabartë me numrin e objekteve që do të kryhen punimet dhe numrin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e kontratës.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga projektuesi, i cili ka pasqyruar krahas preventivit të punimeve, dokumentacionit teknik dhe hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenin 36, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**Argumentimi i specifikimeve teknike për produktet të cilat mbajnë peshën kryesore në realizimin e objektit të kontratës, sipas natyrës së punimeve:**

## KRITERE TEKNIKE TË PËRGJITHSHME:

Mallrat që do të përdoren për kryerjen e punimeve duhet të jenë të shoqëruara me garancitë përkatëse (të përcaktuara në DST dhe në kontratë) në marrëveshjen e përcaktimit të kushteve të garancisë, para lidhjes së kontratës do të definohen dhe mënyrat, koha, dhe çdo specifikim tjetër i vlefshëm dhe i detyrueshëm për palët kontraktuese. Përzgjedhja e specifikimeve teknike të produkteve të tjerë të nevojshëm për realizimin e kontratës është bërë duke u bazuar tek standartet teknike të ofruara sipas kontratave të mëparshme të ngjashme gjatë viteve dhe nevojave reale të institucionit për llojin, sasinë dhe cilësinë e materialeve duke patur parasysh se këto produkte përdoren në ambjente shkollore ku patjetër duhet të përmbushen standartet CE të konfirmimit për cilësinë dhe ndikimin në mjedis. Materialet do të përdoren për mirëmbajtjen e objekteve arsimore, prandaj ato duhet të jenë ekologjike, cilësore dhe të padëmshme për shëndetin e fëmijëve.

Për sa i përket punimeve të parashikuara në preventiv është kërkuar që materialet e parashikuara për t'u përdorur për realizimin e punimeve të përmbushin disa nga standartet teknike shqiptare më të rëndësishme ose ekuivalentet e tyre pasi përmbushja e këtyre standarteve ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e punimeve të objektit. Këto standarte janë të zbatueshme dhe përmbajnë përkufizime dhe kërkesa përfundimtare të performancës së produktit.

Për sa i përket specifikimeve të tjera teknike të vendosura për produktet që do të përdoren në kryerjen e punimeve, janë të përcaktuar vetëm specifikimet bazë të nevojshme me diapazon të arsyeshëm pasi në praktikë kjo ndryshon nga shumë faktorë të cilat ndikojnë në normat e përcaktuara nga mënyra e aplikimit të produkteve dhe destinacioni për të cilën do të përdoren. Këto përcaktime janë në pothuaj të gjitha web-sitet zyrtarë të operatorëve ekonomikë prodhues botërorë ku përcaktohet i njëjti qëndrim për standartet minimalë të produkteve. Të gjitha mallrat të cilat do të lëvrohen nga operatori ekonomik fitues duhet të jenë patjetër konform ofertës teknike të ofruar.

*Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*